



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Bujqësisë
Periudha raportuese	Prill 2018
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Shkumbin Gashi

1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues

Duke u bazuar në planprogramin e punës në kuadër të Drejtorisë, brenda periudhës raportuese janë zhvilluar takime me grupet e interesit-fermerët, shoqatat e ndryshme, institucione të ndryshme etj.

Realizimi i aktiviteteve të ndryshme në Sektorin e bujqësisë që kanë qenë planifikuara në programin e punës.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj .

- Konsulencë për strategjinë afatmesme dhe afatshkurtër në Drejtorinë e Bujqësisë;
- Konsulencë për zhvillimin e sistemit të digjitalizimit-platformë online;
- Vizita tek fermerët përfitues të granteve nga Komuna e Prishtinës, në bashkëpunim me RESI-në austriak;
- Vazhdon deri më 15 prill, aplikimi i fermerëve për subvencione në Ministrinë e Bujqësisë;
- Planifikohet takimi me organizatën turke TIKA;
- Planifikohen takime me përfaqësues nga organizata austriake ADA;
- Planifikohen takime me agronom vendorë;
- Caktimi i kritereve për subvencione në Drejtorinë e Bujqësisë;
- Planifikohet takime me shoqatën vendore “Agro Medicine”;

- Pjesëmarrje në forume për diskutim të çështjeve prioritare të shoqatave të fermerëve;
- Planifikohen takime me fermerë, shoqata dhe grupe të interesit;
- Vizita tek fermerët e komunës së Prishtinës.

3. *AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë:*

- Gjatë takimit të mbajtur, jemi dakorduar të krijohet strategjia afatmesëme dhe afatëshkurtër në Drejtorinë e Bujqësisë;
- Gjatë takimit të mbajtur me ekspertët e sistemit të digjitalizimit, jemi duke e krijuar një platformë “online” për fermerët për Drejtorinë e Bujqësisë;
- Janë vizituar gjithsejtë 4 fermerë përfitues të granteve nga Komuna e Prishtinës, në bashkëpunim me RESI-n austriak;
- Më 15.04.2018, ka përfunduar aplikimi i fermerëve për subvencione në Ministrinë e Bujqësisë, ku dosjet e tyre janë dërguar në AZHB;
- Është zhvilluar takimi me organizatën TIKA, ku është diskutuar për përkrahjen e fermerëve në sektorin e bletarisë;
- Kemi mbajtur takime me përfaqësues nga organizata ADA – Austria, ku kemi diskutuar bashkarisht për përkrahjen e fermerëve dhe më tutje nga kjo organizatë;
- Kemi mbajtur takime konsultative me prof. dr. Agim Zajmin, rreth kulturës (Goji Berry) që e kemi paraparë në buxhet ta financojmë si grant;
- Kemi mbajtur 3 takime me fermerë;
- Kemi mbajtur 2 takime me shoqata (shpezëtare dhe peshkatare);
- Kemi mbajtur takime me fermerë, të karakterit konsultativ, në lidhje me gjetjen e mundësisë për përkrahjen e fermerëve për prodhimtarinë organike, duke përfshirë sigurimin e kontakteve për lejimin e një shtandi për prezantimin e këtyre produkteve në njërin prej shesheve të qytetit, me qëllim të promovimit të këtyre produkteve, e që në të njëjtën kohë ndërlihet edhe me përkrahjen që Drejtoria e Bujqësisë e ka paraparë për këta prodhues;
- Përfundimi i procedurave rreth vendosjes së kriterëve për subvencionet në bujqësi, finalizimi i procesit të komisionit, si edhe hartimi i të gjitha thirrjeve për aplikim për të gjitha subvencionet e parapara për këtë vit në Sektorin e bujqësisë, duke filluar:
 - Thirrja për aplikim për përkrahje në blegtori,
 - Thirrja për aplikim për përkrahje në bletari,

- Thirrja për aplikim për përkrahje në perimekulturë – sistemi i ngrohjes në serra,
- Thirrja për aplikim për përkrahje në prodhimtarinë organike;
- Thirrja për aplikim për përkrahjen e shoqatave të cilat operojnë në territorin e komunës së Prishtinës;
- Thirrja për aplikim për përkrahjen e fermerëve për certifikim organik;
- Pjesëmarrja në “Forumit për diskutimin e çështjeve prioritare për ftesën për propozime për zhvillimin e mëtutjeshëm të shoqatave të fermerëve”, qëllimi i të cilit ka qënë që para përpilimit të udhëzuesit për thirrjen dedikuar për shoqata, bashkërisht me grupet e interes të shqyrtojë kriteret dhe intereset prioritare të shoqatave, e që ka të bëjë me përkrahjen nga ADA;
- Konsultime me shoqatën “Agro Medicine” për sa i përket certifikimit të prodhuesëve organikë.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.

- Jemi duke realizuar vizita në sektorët e ndryshëm të Drejtorisë së Bujqësisë.

4.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese

- Nuk janë planifikuar për këtë periudhë.

4.1.3 Takimet me palë

- Kanë qënë 40 takime me palë.

5. Takimet me institucione të tjera

- Nuk ka pasur.

6. Diskutime publike/Takimet me qytetarë

- Nuk ka pasur.

6.1.1 Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare

- Nuk ka pas kërkesa të tilla.

6.1.2. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

7. Takime të tjera

- Nuk ka pasur.

8. SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, psh: pengesa brenda Drejtorisë, Komunës, apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

9. REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë etj.

10. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES - Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:

- Monitorimi i punëve për strategjinë afatmesme dhe afatshkurtër në Drejtorinë e Bujqësisë;
- Monitorimi i punëve për zhvillimin e sistemit të digjitalizimit-platformë “online”;
- Vizita te fermerët përfitues të granteve nga Komuna e Prishtinës, në bashkëpunim me RESI-n austriak;
- Planifikohen takime me fermerë dhe grupe të interesit;
- Planifikohet të implementohet punëtorja për krijimin e Qendrës Komunale për Zhvillim (QKZ);
- Takime me përfaqësues të KFOR-it rreth menaxhimit të pyjeve;
- Përzgjedhja e përfituesit të tenderit “Vaksinimin e gjedheve, kafshëve të imëta dhe qenve me pronarë”.

11. TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme